

EC Ma Ndryshe, Fondacioni për Trashëgimi Kulturore, Forumi për Trashëgimi Kulturore, Academy for Training and Technical Assistance, N'GO, Instituti Demokratik i Kosovës – dega në Prizren, GreenArt, X40, EUIRC, Ura e Artit, Durmish Asllano, ICEC, Old timer Club Prizren, Shoqata e Bjeshtetarëve Sharri

26 tetor 2011, Prizren

REAGIM

...i shoqërisë civile të Prizrenit ndaj Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Ne, organizatat e poshtënjshkruara të shoqërisë civile të Prizrenit jemi thellësisht të shqetësuara për nivelin deri ku institucionet shtetërore mund ta nënçmojnë vullnetin e qytetarëve. Konkretisht, ky shqetësim i yni lidhet me mënyrën se si Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e ka raportuar debatin e saj me shoqërinë civile të Prizrenit mbi ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit. Në tentim-debatin e javës së kaluar me shoqërinë civile, MMPH dhe OJQ Urbaniak, kanë tentuar që në mënyrë klandestine të improvizojnë procesin e konsultimeve publike për këtë projekt-ligj.

Organizatori i këtij debati publik kishte tentuar të mos lejojë pjesëmarrjen e të gjithë qytetarëve të interesuar në debat, ndërsa mediet kanë qenë plotësisht të përjashtuar duke iu mohuar mundësia e përcjelljes së diskutimeve të debatit. I gjithë ky teatër demokratik e kishte arritur kulmin e shëmtisë së tij me një prezencë frikshme të forcave të rendit, ofendime, kërcënime e deri në sulme verbale dhe fizike ndaj pjesëtarëve të shoqërisë civile të qytetit. Prandaj, shoqëria civile dhe komuniteti i Prizrenit për të shprehur pakënaqësinë dhe protestën e vet me këto praktika, ka lëshuar sallën e debatit menjëherë pas nisjes së tij, duke i artikuluar të gjitha pakënaqësitë e saj në lidhje me përmbajtjen e projekt-ligjit dhe me procesin e hartimit dhe miratimit të tij.

Përkundër gjithë këyre, MMPH në web-faqen e saj ka raportuar se ky debat është mbajtur në mënyrë të rregullt, me pjesëmarrjen e të gjithëve, përfshi shoqërinë civile dhe se janë diskutuar aspekte të ndryshme të këtij projekt-ligji (mund të lexoni në mmph.rks-gov.net). Për më tepër, OJQ-ja anonime prishtinase "Urbaniak" e kontraktuar nga Ministria për të organizuar këtë debat, menjëherë pas publikimit të lajmit në web-faqen e Ministrisë, u ka dërguar një email organizatave të ftuara në debat, duke i falenderuar ata për kinse "pjesëmarrjen dhe kontributin" e tyre në këtë debat. Kjo hipokrizi e Ministrisë është edhe një dëshmi për logjikën nënçmuese dhe praktikën shkelëse të qeverisë ndaj vullnetit të qytetarëve.

Për të kundërshtuar këtë logjikë dhe praktikë, po ia ripotencojmë dhe rikujtojmë Ministrinë nonshallant të MMPH-së disa fakte rreth këtij procesi dhe disa parime të demokracisë:

- Tentim-debati i javës së kaluar me shoqërinë civile është mbajtur vetëm me institucione të shtetit dhe ato ndërkombëtare, pasi që shoqëria civile dhe qytetarët e kanë lëshuar sallën e debatit menjëherë pas fillimit të tij,
- Ministri është duke e injoruar në mënyrë konstante vullnetin e qytetarëve të Prizrenit. Thua se Peticioni kundërshtues me mbi 10.000 nënshkrime nuk ekziston fare, dhe thua se OJQ-të e qytetit deri tani nuk janë deklaruar asnjëherë kundër projekt-ligjit, Ministri tenton të organizojë debate ose konsultime publike për të njëjtin dokument,
- Ky injorim i pashembullt duhet të ndërpritet dhe Ministri duhet të japë llogari shoqërisë civile të Prizrenit dhe gjithë qytetarëve të Prizrenit, e sidomos atyre që e kanë nënshkruar Peticionin për injorimin që po iu bën,
- Ministri është duke e shkelur autoritetin e Kuvendit të Kosovës dhe Rregulloren e Qeverisë së Kosovës, pasi që, derisa projekt-ligji tashmë gjendet në shqyrtim parlamentar, ai po tentoni të organizojë konsultime publike për projekt-ligjin,
- Në mënyrë konstante Ministri është përpjekur të ofendojë intelegjencën e shoqërisë civile të Prizrenit duke deklaruar se gjatë dy viteve sa po hartohet projekt-ligji, MMPH ka zhvilluar konsultime me shoqërinë civile. Ndërsa asnjëherë nuk ka dhënë llogari për këto konstatime, dhe asnjëherë nuk ka ofruar fakte dhe informata të sakta. Ne ende qëndrojmë mbas konstatimit tonë se Ministri ka gënjer dhe po vazhdon të gënjejë në lidhje me konsultimet publike për projekt-ligjin,

- Ministri gjithashtu, që nga fillimi, është duke gënjyer kur po thotë se “ligji për Qendrën Historike të Prizrenit” është obligim që del nga Pakoja e Ahtisaarit. Nëse ai na dëshmon se në cilën pjesë të Pakos shkruan se duhet të nxjerret një LIGJ për të themeluar këtë Qendër, atëherë ne automatikisht do ta shuajmë gjithë iniciativën dhe reagimet tona kundërshtuese,

Dhe për fund, Ministri duhet të jetë i vetëdijshëm se sa më shumë që do të injorojë vullnetin e qytetarëve të Prizrenit, aq më të fuqishëm dhe të organizuar do të jenë ata për të kundërshtuar çfarëdo imponimi ose shkelje ndaj këtij vullneti.

Organizatat e nënshkruara:

EC Ma Ndryshe,

Fondacioni për Trashëgimi Kulturore,

Forumi për Trashëgimi Kulturore,

Academy for Training and Technical Assistance,

N’GO,

Instituti Demokratik i Kosovës – dega në Prizren,

GreenArt,

X40,

EUIRC,

Ura e Artit,

Durmish Asllano,

ICEC,

Old timer Club Prizren,

Shoqata e Bjeshkatarëve Sharri